VENDIM
Nr. 613, datë 22.9.2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR ZHVILLIMIN E INTEGRUAR URBAN DHE TURIZMIN, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 19/2017

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit për zhvillimin e integruar urban dhe turizmin, ratifikuar me ligjin nr. 19/2017, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Banka Botërore
IBRD – IDA/Grupi i Bankës Botërore

Zyra e Grupit të Bankës Botërore
Rruga "Ibrahim Rugova", nr. 34
Tiranë, Shqipëri

Emanuel Salinas
Menaxher për Shqipërinë

8 shkurt 2022

Nr. prot. 04/22

Shkëlqesisë së Saj, Delina Ibrahimaj
Ministre
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë, Shqipëri

E nderuar znj. Ministre,

Shqipëria: Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin
Amendim i Marrëveshjes së Huas nr. 8656 – AL

Ju lutem gjeni bashkëlidhur për siglim nga ana juaj 2 (dy) kopje origjinale të Amendimit të Huas nr. 8656 – AL për Projektin e Zhvillimit të Integruar Urban dhe Turizmit.

Ju lutem ktheni tek Zyra e Bankës Botërore në Tiranë 1 (një) kopje të nënshkruar të Amendimit.

Me respekt,
Emanuel Salinas
Menaxher i Bankës Botërore për Shqipërinë
Evropën dhe Rajonin e Azisë Qendrore
Tel: + 355 42280 650/51 Faks: +355 42240 590

BANKA BOTËRORE
IBRD – IDA/GRUPI I BANKËS BOTËRORE

8 shkurt 2022

Shkëlqesisë së Saj, Delina Ibrahimaj
Ministre e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë,
Republika e Shqipërisë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË:
PROJEKTI PËR ZHVILLIMIN E INTEGRUAR URBAN DHE TURIZMIN
(Huaja nr. 8656 – AL)
Amendim i Marrëveshjes së Huas

Shkëlqesi:

I referohemi Marrëveshjes së Huas, datë 13 dhjetor 2016, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka) (Marrëveshja e Huas) për Projektin e lartpërmendur për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin (Projekti). Gjithashtu, i referohemi shkresës tuaj, datë 14 maj 2020, dhe bisedimeve pasuese ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit për amendimin e Marrëveshjes së Huas për reflektimin e ndryshimeve në Projektin e përfshirë në Marrëveshjen e Huas ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit për Financim Shtesë të Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin (Marrëveshja e Financimit Shtesë).

Banka dhe Huamarrësi bien dakord që Marrëveshja e Huas të amendohet, si më poshtë:

1. a) Të gjitha referencat "Ministria e Zhvillimit Urban" ose "MZHU" zëvendësohen me referencat "Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë" ose "MIE"; b) të gjitha referencat "Ministria e Financave" ose "MF" zëvendësohen me referencat "Ministria e Financave dhe Ekonomisë" ose "MFE"; dhe c) të gjitha referencat "Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes" ose "MZHETTS", dhe "Ministria e Mjedisit" ose "MM" bashkohen dhe zëvendësohen me referencat "Ministria e Turizmit dhe Mjedisit" ose "MTM".

2. Skeduli 1 ndryshon dhe lexohet në tërësinë e tij si siç përcaktohet në shtojcën e kësaj shkrese amendimi.

3. Seksioni 1.A, i skedulit 2 ndryshon dhe lexohet në tërësinë e tij si më poshtë:

"A. Masat institucionale

1. Njësia për Koordinimin e Projektit dhe MIE

a) Huamarrësi, nëpërmjet MIE-s:

i. mban gjatë të gjithë kohës së zbatimit të Projektit NJKP në e tij, stafi kryesor i së cilës ka në përbërje një urbanist, një specialist të turizmit dhe një arkitekt, ku të gjithë kanë kualifikime dhe përvojë, dhe sipas termave të referencës të pranueshme për Bankën; dhe

ii. garanton që NJKP-ja e tij të kryejë mbikëqyrjen e Projektit dhe bashkërendimin e kontributeve teknike të Bashkive të Përzgjedhura; dhe

iii. bashkërendon me KDP-në mbi përgjegjësitë e KDP-së, në lidhje me zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë zbatimit të Projektit, si dhe lehtësimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet agjencive kryesore qeveritare të përfshira në zbatimin e Projektit me bashkitë e përzgjedhura;

b) Huamarrësi, nëpërmjet MIE-s, nxit Entin Zbatues të Projektit që:

i. gjatë të gjithë kohës së zbatimit të Projektit të mbajë stafin e tij kryesor që ka në përbërje një menaxher të Projektit, një arkitekt, një inxhinier, një specialist për administrimin financiar, një specialist prokurimi, një specialist turizmi, një specialist për angazhimin qytetar, një specialist mjedisi dhe një specialist për problemet sociale, ku të gjithë kanë kualifikime, përvojë, përgjegjësi dhe iniciativë të pranueshme për Bankën; dhe

ii. të realizojë zbatimin e Projektit, duke përfshirë administrimin financiar, prokurimin dhe menaxhimin e kontratës.

2. Komiteti Drejtues i Projektit

Huamarrësi:

a) mban, gjatë të gjithë kohës së zbatimit të Projektit, një Komitet Drejtues të Projektit (KDP) që ka në përbërje përfaqësues nga MIE, MTM-ja, MK-ja, MFE-ja, Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, Enti Zbatues i Projektit dhe bashkitë e përzgjedhura; dhe çdo përfaqësues tjetër të parashikuar në Manualin e Operimit të Projektit; dhe

b) garanton që KDP-ja: i. të mblidhet të paktën çdo gjashtë (6) muaj; ii. të mbështesë MIE-n për të mbikëqyrur në mënyrë tërësore menaxhimin e Projektit, përfshirë, ndër të tjera, mbështetjen për bashkërendimin e palëve të interesuara dhe zgjidhjen e çështjeve ose problemeve të rëndësishme ndërrajonale/sektoriale të shkaktuara gjatë zbatimit të Projektit.

4. Seksioni B.1 (A) i skedulit 2 ndryshon dhe lexohet në tërësinë e tij, si më poshtë:

a) Jo më vonë se 90 ditë pas datës së hyrjes në fuqi, Huamarrësi, nëpërmjet MIE-s, nxit Entin Zbatues të Projektit që të përditësojë, miratojë, dhe më pas ta realizojë dhe zbatojë Projektin në përputhje me dispozitat e një manuali (Manuali Operacional i Projektit) në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, i cili përmban: i. një përshkrim të detajuar të Projektit; ii. listën e zonave të përzgjedhura turistike, zonat e përzgjedhura dhe bashkitë e përzgjedhura; iii. procedurat e zbatimit të Projektit; iv. masat e detajuara institucionale, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe ligjet dhe rregulloret e zbatueshme, dhe duke përfshirë, ndër të tjera, grafikët e veprimeve që kërkohet të kryhen në kuadër të Projektit, stafin, aspektet fiduciare, aspektet teknike dhe operative dhe procedurat për zbatimin e Projektit; v. procedurat e administrimit financiar (buxhetimi, kontabiliteti dhe kontrolli i brendshëm, disbursimi dhe qarkullimi i fondeve, raportimi financiar, raportet vjetore, procedurat për planifikimin e auditimeve të brendshme dhe të jashtme, si dhe përfshirë planin e posaçëm kontabël të Projektit); vi. Marrëveshjen model të Bashkëpunimit; vii. procedurat e prokurimit; viii. KMMS-në dhe KPR-në; ix. masat e vlerësimit dhe monitorimit të Projektit; x. treguesit e monitorimit të projektit; dhe xi. dhe masat e tjera fiduciare dhe administrative, manual ky që mund të ndryshohet herë pas here me miratimin e Bankës.".

5. Seksioni II, i skedulit 2 ndryshon dhe lexohet në tërësinë e tij, si më poshtë:

"Huamarrësi, nëpërmjet MIE-s, i dorëzon Bankës çdo raport të Projektit jo më vonë se një muaj pas mbarimit të çdo semestri kalendarik që mbulon semestrin kalendarik.".

6. Seksioni III i skedulit ndryshon për t'u lexuar në tërësinë e tij, si më poshtë:

"Seksioni III. Prokurimi

Rregulloret e Prokurimit

Të gjitha mallrat, shërbimet e jokonsulencës dhe shërbimet e konsulencës që kërkohen për Projektin dhe që duhen financuar me të ardhurat nga Huaja, dhe për të cilat procesi i prokurimit fillon në apo pas datës së nënshkrimit, prokurohen në përputhje me kërkesat që parashikohen apo përmenden në rregulloret e prokurimit dhe dispozitat e Planit të Prokurimit.

Udhëzuesi për Prokurimin dhe udhëzuesi për Konsulentin

A. Të përgjithshme

1. Mallra, punime dhe shërbime jokonsulence. Të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet e jokonsulencës që kërkohen për Projektin dhe që duhen financuar me të ardhurat nga Huaja dhe për të cilat procesi i prokurimit fillon në apo pas datës së nënshkrimit, prokurohen në përputhje me kërkesat që parashikohen apo përmenden në seksionin I të Udhëzuesit për Prokurimin, si dhe me dispozitat e këtij seksioni.

2. Shërbimet e konsulentëve. Të gjitha shërbimet e konsulentëve që kërkohen për Projektin dhe që duhen financuar me të ardhurat nga Huaja, dhe për të cilat procesi i prokurimit fillon në apo pas datës së nënshkrimit, prokurohen në përputhje me kërkesat që parashikohen apo përmenden në seksionet I dhe IV, të Udhëzuesit për Konsulentët, si dhe me dispozitat e këtij seksioni.

3. Përkufizime. Termat e shkruara me germa kapitale që përdoren më poshtë në këtë seksion për të dhënë një përshkrim të metodave të posaçme të prokurimit apo metodave të Bankës për shqyrtimin e marrëveshjeve të posaçme, i referohen metodës përkatëse, një përshkrim i së cilës jepet në seksionet II dhe III, të Udhëzuesit për Prokurimin, apo në seksionet II, III, IV dhe V ,të Udhëzuesit për Konsulentët, sipas rastit.

B. Metodat e posaçme të prokurimit të mallrave, punimeve dhe shërbimeve të jokonsulencës

1. Oferta ndërkombëtare për konkurrim. Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, mallrat, punimet dhe shërbimet e jokonsulencës prokurohen sipas kontratave fituese që jepen mbi bazën e ofertës ndërkombëtare për konkurrim.

2. Metoda të tjera për prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve të jokonsulencës. Metodat e mëposhtme, përveç ofertës ndërkombëtare për konkurrim, mund të përdoren për prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve të jokonsulencës për ato kontrata që përcaktohen në Planin e Prokurimit: a) oferta kombëtare për konkurrim sipas dispozitave shtesë të paragrafit 3 të këtij seksioni; b) blerje; dhe c) kontraktimi i drejtpërdrejtë.

3. Ndryshime të procedurave të huamarrësit, në lidhje me ofertën kombëtare për konkurrim. Procedurat, në lidhje me Ofertën Kombëtare për Konkurrim (OKK), bazohen në procedura të hapura tenderimi, siç është përcaktuar në ligjin shqiptar në fuqi për prokurimin, me kusht, sidoqoftë, që një procedurë e tillë t'u nënshtrohet dispozitave të seksionit I dhe paragrafëve 3.3 dhe 3.4, të Udhëzuesit për Prokurimin dhe dispozitave shtesë të mëposhtme:

a) procedurat "e hapura të tenderimit", siç është përcaktuar në LPP-në e Shqipërisë, zbatohen për të gjitha marrëveshjet e financuara nga Banka;

b) ofertuesit e huaj nuk përjashtohen nga paraqitja e ofertave dhe nuk u jepet asnjë preferencë e ndonjë lloji ofertuesve vendas në procesin e tenderit. Në Shqipëri lejohet që ndërmarrjet shtetërore të paraqesin oferta vetëm në rast se janë të pavarura nga pikëpamja ligjore dhe financiare, dhe veprojnë në bazë të së drejtës tregtare të Huamarrësit. Regjistrimi nuk përdoret për të vlerësuar kualifikimet e ofertuesve;

c) ofertat hapen në mënyrë publike, në një vend, menjëherë pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave, në prani të përfaqësuesve të cilët vendosin të marrin pjesë;

d) entet prokuruese përdorin dokumente model të tenderit, siç janë miratuar nga Banka;

e) në rast të çmimeve më të larta të ofertave, krahasuar me vlerësimin zyrtar, asnjë ofertë nuk refuzohet pa marrëveshje paraprake të Bankës;

f) për paraqitjen e ofertave përdoret procedura me një zarf të vetëm;

g) paskualifikimi bëhet vetëm për ofertuesin me vlerësimin më të ulët; asnjë ofertë nuk refuzohet në kohën e hapjes së ofertave për arsye kualifikimi;

h) ofertuesit, në formën e sipërmarrjes së përbashkët, mbajnë përgjegjësi në mënyrë solidare dhe individuale;

i) kërkohet marrja e miratimit paraprak të Bankës para se të refuzohen të gjitha ofertat dhe të kërkohen oferta të reja;

j) kontratat i jepen ofertuesit kryesisht të kualifikuar, me vlerësimin më të ulët, i cili është vendosur të kualifikohet që të veprojë në përputhje me kriteret e vlerësimit, të përcaktuara dhe të publikuara më parë;

k) nuk lejohet negocimi pas tenderimit me ofertuesin që ka vlerësimin më të ulët apo me ndonjë ofertues tjetër;

l) kontratat e gjata (mbi 18 muaj) përmbajnë dispozita për rregullimin e çmimit të përshtatshëm, të pranueshme për Bankën;

m) sigurimet e ofertave dhe kontratave janë në formatin që përfshihet në dokumentet e tenderit që përmenden në pikën "d" më lart. Sigurimi i ofertës është i vlefshëm deri njëzet e tetë (28) ditë pas përfundimit të periudhës fillestare të vlefshmërisë së ofertës apo pas përfundimit të çdo periudhe të zgjatur, nëse kërkohet. Nuk kryhet asnjë pagesë paradhënie pa një garanci të përshtatshme të pagesës së paradhënies;

n) dokumenti i tenderit dhe kontrata që çmohen të pranueshme nga Banka, përmbajnë dispozita që paraqesin politikën e Bankës për ndalimin e firmave apo individëve, të përfshirë në vjedhje dhe korrupsion, siç është përcaktuar në Udhëzuesin për Prokurimin;

o) në përputhje me Udhëzuesin për Prokurimin, çdo dokument tenderi dhe kontratë që financohet me të ardhura nga Huaja, parashikon që ofertuesit, furnitorët dhe kontraktuesit, si dhe nënkontraktuesit, agjentët, personeli, konsulentët, ofruesit e shërbimeve apo furnitorët e tyre lejojnë që Banka të inspektojë të gjitha llogaritë, dokumentacionin dhe dokumente të tjera, në lidhje me paraqitjen e ofertave dhe zbatimin e kontratës, dhe t'ia nënshtrojë auditimit nga auditues të caktuar nga Banka. Pa u kufizuar tek dispozitat e paragrafit 1.16 (a) (v) (bb) të Udhëzuesit për Prokurimin, veprimet që synojnë të pengojnë kryesisht ushtrimin nga ana e Bankës të të drejtave të saj për inspektim dhe auditim sipas Udhëzuesit për Prokurimin, përbëjnë një praktikë penguese, siç është përcaktuar në Udhëzuesin për Prokurimin.

C. Metoda të posaçme të prokurimit të shërbimeve të konsulencës

1. Përzgjedhja mbi bazën e cilësisë dhe kostos. Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, shërbimet e konsulencës prokurohen sipas kontratave që jepen sipas përzgjedhjes mbi bazën e cilësisë dhe kostos.

2. Metoda të tjera të prokurimit të shërbimeve të konsulencës. Metodat e mëposhtme, përveç përzgjedhjes mbi bazën e cilësisë dhe kostos, mund të përdoren për prokurimin e shërbimeve të konsulencës për ato kontrata që përcaktohen qartë në Planin e Prokurimit: a) përzgjedhja mbi bazën e cilësisë; b) përzgjedhja sipas një buxheti fiks; c) përzgjedhja e kostos më të ulët; d) përzgjedhja mbi bazën e kualifikimeve të konsulentëve, e) përzgjedhja me burim të vetëm të firmave të konsulencës; f) procedurat që parashikohen në paragrafët 5.2 dhe 5.3 të Udhëzuesit për Konsulentët, në lidhje me përzgjedhjen e konsulentëve të veçantë; dhe g) procedurat me burim të vetëm për përzgjedhjen e konsulentëve të veçantë.

D. Shqyrtimi nga Banka i vendimeve për prokurimin

Plani i Prokurimit përcakton ato kontrata që janë objekt i shqyrtimit paraprak nga ana e Bankës. Të gjitha kontratat e tjera janë objekt i shqyrtimit të mëpasshëm nga ana e Bankës.".

7. Seksioni IV.B.2, i skedulit 2 ndryshon dhe lexohet si më poshtë:

"2. Data e mbylljes është data 31 korrik 2025.".

8. Seksioni V, i skedulit 2 ndryshon dhe lexohet si më poshtë:

"1. Huamarrësi, nëpërmjet MIE-s, nxit Entin Zbatues të Projektit të sigurojë që çdo studim për projektime urbane, i ndërmarrë në kuadër të pjesës 1 (a) të Projektit, të jetë i pranueshëm për Bankën.

2. Huamarrësi nuk kërkon tërheqje për shpenzime të arsyeshme sipas kësaj Marrëveshjeje: i. të cilat janë financuar ndërkohë me të ardhura nga Marrëveshja e Financimit Shtesë; ose ii. për të cilat ka kërkuar tërheqje sipas Marrëveshjes së Financimit Shtesë.".

9. Shtojca ndryshohet si më poshtë:

a) Përkufizimet e mëposhtme ndryshohen dhe lexohen si më poshtë:

""Udhëzuesi për Antikorrupsionin" do të thotë: ose a) "Udhëzuesi për të parandaluar dhe luftuar vjedhjen dhe korrupsionin në projekte të financuara me hua nga IBRD-ja dhe hua e grante nga IDA", e datës 15 tetor 2006, e rishikuar në janar 2011 dhe më 1 korrik 2016, i zbatueshëm për veprimtari të projektit që financohen me të ardhura nga huaja në apo pas datës së nënshkrimit (përveç atyre të prokuruara sipas Udhëzuesit për Prokurimin apo Udhëzuesit për Konsulentët); ose b) "Udhëzuesi për të parandaluar dhe luftuar vjedhjen dhe korrupsionin në projekte të financuara me hua nga IBRD-ja dhe hua e grante nga IDA", i datës 15 tetor 2006, i rishikuar në janar 2011, të zbatueshëm për veprimtari të Projektit që financohen me të ardhura nga huaja para datës së nënshkrimit.

"Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje" do të thotë njësia në Zyrën e Kryeministrit, më parë i referuar si Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, që është ngritur dhe vepron në bazë të urdhrit të Kryeministrit nr. 204, datë 1 nëntor 2013, apo pasuesi i tij.

"Agjencitë Shtetërore Qendrore Pjesëmarrëse" do të thotë "MK", "MTM", "MFE" dhe "MIE".

"Plan Prokurimi" do të thotë plani i prokurimit të Huamarrësit për Projektin, datë 15 korrik 2016 dhe i përmendur në paragrafin 1.18 të Udhëzuesit për Prokurimin dhe paragrafin 1.25 të Udhëzuesit për Konsulencën, dhe i parashikuar sipas seksionit IV të rregulloreve të prokurimit, i cili përditësohet herë pas here me miratimin e Bankës.

"Manual Operacional i Projektit" do të thotë manuali i përmendur në seksionin I. B. 1 (a) të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

"Zona të Përzgjedhura" do të thotë bashkitë e përzgjedhura, korridori turistik dhe të gjitha zonat e tjera brenda territorit të Huamarrësit, të parashikuara në Manualin Operacional të Projektit.

"Bashki të Përzgjedhura" do të thotë bashkitë e Huamarrësit të parashikuara në Manualin Operacional të Projektit.

"Korridor Turistik" do të thotë rruga e transportit që lidh qytetin e Vlorës me bashkitë e përzgjedhura, siç përshkruhet më tej në Manualin Operacional të Projektit.".

b) Përkufizimet e mëposhtme janë shtuar dhe lexohen si më poshtë (dhe përkufizimet e mbetura janë riemërtuar për të ruajtur rendin alfabetik):

""Marrëveshje Financimi Shtesë" do të thotë marrëveshja ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës për Financimin Shtesë për Shqipërinë, Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin.

"COVID-19" do të thotë sëmundja e koronavirusit e shkaktuar nga koronavirusi i ri i vitit 2019 (SARS-CoV-2).

"MTM" do të thotë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e Huamarrësit apo pasuesi i saj.

"MFE" do të thotë Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Huamarrësit apo pasuesi i saj.

"MIE" do të thotë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Huamarrësit apo pasuesi i saj.

"Rregullore Prokurimi" do të thotë, për qëllime të paragrafit 85, të shtojcës së Kushteve të Përgjithshme, "Rregulloret e Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit FPI", e korrikut të vitit 2016, e rishikuar në nëntor 2017, gusht 2018 dhe nëntor 2020.

"Datë nënshkrimi" do të thotë data e fundit nga dy datat në të cilat Huamarrësi dhe Banka kanë nënshkruar Marrëveshjen e Financimit Shtesë.".

c) Përkufizimet e mëposhtme janë fshirë (dhe përkufizimet e mbetura janë riemërtuar për të ruajtur rendin alfabetik): "Plani Vjetor i Punës dhe Buxheti"; "MZHETTS"; "MM"; dhe "MF"; "MZHU".

Të gjitha dispozitat e Marrëveshjes së Huas, përveç atyre të ndryshuara në këtë marrëveshje, mbeten në fuqi dhe efekt të plotë.

Ju lutem tregoni dakordësinë tuaj për sa më sipër, në emër të Huamarrësit, duke sigluar dhe vendosur datën tek të dyja kopjet origjinale të kësaj shkrese që u janë dërguar dhe na ktheni njërën kopje origjinale të sigluar.

Dispozitat e parashikuara në këtë shkresë amendimi do të hyjnë në fuqi pasi të jenë përmbushur të gjitha kushtet e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Financimit Shtesë. Pas përmbushjes së kushteve të lartpërmendura, Banka do t'i dërgojë Huamarrësit një njoftim për hyrjen në fuqi.

Me respekt,
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: _____
Emanuel Salinas Munoz
Menaxher për Shqipërinë

KONFIRMUAR:
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____
Përfaqësuesi i Autorizuar

Datë: _____

SHTOJCA
Skeduli 1
Përshkrimi i Projektit

Objektivat e Projektit janë: a) përmirësimi i infrastrukturës urbane; b) shtimi i aseteve për turizmin; dhe c) fuqizimi i kapaciteteve institucionale për të mbështetur turizmin, në lidhje me zhvillimin ekonomik vendas të Zonave të Përzgjedhura në jug të Shqipërisë.

Projekti konsiston në pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1: Modernizimi urban dhe përmirësimi i infrastrukturës

Modernizimi i infrastrukturës në Zonat e Përzgjedhura me anë të: a) përgatitjes së studimeve të fizibilitetit dhe projekteve (duke përfshirë studimet për projektime urbane); b) kryerjes së punimeve ndërtimore për restaurimin e godinave të përzgjedhura me vlerë historike; c) zhvillimit të hapësirave publike, rrjetit rrugor dhe infrastrukturës bashkëshoqëruese; dhe d) kryerjes së mbikëqyrjes së ndërtimeve.

Pjesa 2: Zhvillimi i zonave turistike

Përmirësimi i zonave të përzgjedhura turistike përgjatë jugut të Korridorit Turistik të Shqipërisë, mes të tjerash: a) duke restauruar asetet e përzgjedhura kulturore dhe të trashëgimisë, dhe duke krijuar zona pushimi ose pika turistike; b) duke riparuar dhe përmirësuar infrastrukturën e zonave turistike, si rrugët për këmbësorë; c) duke përgatitur studimet e nevojshme të fizibilitetit, planet për menaxhimin e zonave turistike dhe projektet inxhinierike; dhe d) duke kryer mbikëqyrjen e ndërtimeve.

Pjesa 3: Zhvillimi i tregut dhe i produkteve të turizmit

Fuqizimi i kapaciteteve të bashkive për kryerjen e shërbimeve bashkiake dhe mbështetjen e zhvillimit të tregut dhe produkteve të turizmit mes të tjerash, përmes, ndër të tjera: i. sigurimit të pajisjeve për grumbullimin e mbetjeve të ngurta; ii. krijimit të aftësive menaxheriale të zonave turistike për përmirësimin e aktivitetit të aseteve të rehabilituara; iii. përpilimit dhe zbatimit të strategjive për kërkimet në treg dhe krijimin e produkteve; iv. krijimit të partneriteteve institucionale për të nxitur veprimtari të menaxhimit në destinacion, në nivel bashkiak dhe nivel

qarku, përfshirë reagimin në rast urgjencash shëndetësore, si p.sh. COVID-19; v. përpilimin dhe zbatimin e statistikave të përmirësuara të turizmit kombëtar në Shqipëri.

Pjesa 4: Mbështetja për zbatimin

Ofrimi i mbështetjes për realizimin e zbatimit të Projektit, duke përfshirë mirëmbajtjen e sistemit për monitorimin dhe vlerësimin e Projektit, si dhe trajnimin dhe financimin e kostove operative.